



**AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ANONIME
"ALBANIAN PARTENERS ABSORBER" sh.a.**

Sot, në Tiranë, me datën 12.05.2004, zoti **Adriatik Dudaj**, i biri i Gafurit, lindur me 1970 në Tiranë, banues në Tiranë, Rr "Sami Frasheri" Nr. 41 Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plote për të vepruar ka themeluar shoqëri të anonime **"ALBANIAN PARTENERS ABSORBER" SHA** si më poshtë:

**Neni 1
Themelimi**

Zoti Adriatik Dudaj shpreh vullnetin e tij për themelimin në Shqipëri të Shoqërisë Anonime "APA" sh.a, i cili tani e tutje në këtë akt do të quhet Aksioneri i vetëm i shoqërisë. Ai hartoi për këtë qëllim Aktin e Themelimit të shoqërisë "APA" Sh.A.

**Neni 2
Baza ligjore**

Shoqëria "APA" sh.a themelohet në përputhje me Ligjin me 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3
Lloji dhe Emri**

Kjo shoqëri është "SHOQËRI ANONIME" e cila mban emrin "ALBANIAN PARTENERS ABSORBER" SHA, me initiale "APA" Sh.A. Ky emër duhet të figurojë në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del nga shoqëria.

**Neni 4
Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga "Hamdi Pepa" pranë tregut ushqimor. Selia mund të ndryshohet me vendim të Këshillit Mbikëqyres.

**Neni 5
Kapitali**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 2 000.000 (dymilion) leke dhe zotërohet 100 % nga aksioneri i vetëm i shoqërisë Adriatik Dudaj.

**Neni 6
Objekti**

Shoqëria ka si objekt të saj :

Importimin, eksportimin dhe tregtimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme, të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregtar, ushqimor, të shërbimeve etj. në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Prodhimin e mallrave të ndryshme industriale dhe bujqësore.



Kryerjen e veprimtarive të shërbimit e riparimit të karakterit mekanik, elektrik, elektronik, komunal e të llojeve të tjera.

Veprimtari në fushën e hotelerisë, turizmit bar-restorante, fast food, lojra argetuese etj.
Studio për përgatitjen e spoteve publike, të reklamave, agjensi në fushën e reklamave, studio grafike, veprimtari në fushën e kinematografisë dhe të filmit.

Veprimtari në fushën e telekomunikacionit, si operator për ofrimin e shërbimeve të internetit, të telefonisë rurale, asaj me vlerë të shtuar, etj.

Veprimtari në fushën sportive, organizimi i garave sportive, ndertimi dhe administrimi i qendrave sportive, përgatitja e ekipeve sportive, organizimi i trajnimit të sportistëve, trajnimeve etj.

Zhvillimin e veprimtarive në fushën e turizmit, transportit të udhëtarëve, përgatitja e guidave, shërbimeve të përbashkëta turistike, etj.

Transporti i mallrave të ndryshme, eksport-importi i tyre etj.

Prodhimin (shtypshkrimin), shpërndarjen dhe tregtimin e botimeve të ndryshme si: tekste shkollore për të gjitha nivelet, libra artistike, libra tekniko-shkencore, enciklopedike, dispenca, revista, gazeta, fletore, formulare, flete-palosje, pankarta, afishe, kartvizite, portera, etj..

Për këto veprimtari Shoqëria mund të hapë njësi shitjeje të specializuara në qytete të ndryshme të vendit.

Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar e financiar që lidhet drejtpërdrejt me këtë objekt të saj.

Neni 7

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në gjykatë.

Neni 8

Struktura

Shoqëria do të ketë organet e saj që janë ;

1. Asambjeja e Aksionerëve.
2. Këshilli Mbikqyres.
3. Drejtoria (Drejtori i Përgjithshëm).

Menyra e funksionimit të këtyre organeve parashikohet në Statutin e shoqërisë.


Drejtor i Përgjithshëm është z. Ledia Çurri

Kryetar i Këshillit Mbikqyres është Z.Adriatik Duda.

Neni 9

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Organ për zgjidhjen e mosmarreveshjeve, kur nuk është e mundur të zgjidhen me mirekuptim do të jetë Gjykata e rrethit Tiranë.



Neni 10
Akti i Themelimit

Hartimi i aktit te themelimit behet ne 4 (kater) kopje origjinale, ne gjuhen shqipe dhe me vlere te barabarte. Ketij akti themelimi i bashkelidhet edhe statuti i shoqerise.

Neni 11
Hyrja ne Fuqi

Ky akt themelimi, qe gjendet ne pajtim te plote me vullnetin e lire te aksionerit te vetem themelues Adriatik Dudaj do te hyje ne fuqi sot ne ditën e tij te nenshkrimt me daten 12.05.2004.

AKSIONERI THEMELUES

Adriatik DUDAJ



STATUTI

I SHOQERISE ANONIME «ALBANIAN PARTENERS ABSORBER » SHA

Themeluesi i shoqerise « ALBANIAN PARTENERS ABSORBER » SHA dhe aksioner i vetem i kesaj shoqerie, zoti Adriatik DUDAJ, i biri i Gafurit, i datelindjes 1970, banues ne Tirane Rruga "Sami Frasheri" nr. 41. shtetas shqiptar dhe me zotesi juridike per te vepruar, në përputhje me Ligjin me 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenshkruan si me poshte statutin e shoqerise anonime "APA" SHA;

Neni 1 Forma

Shoqeria eshte e formes anonime pa oferte publike ne perputhje me ligjislacionin ne fuqi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

Neni 2 Emertimi, vula dhe logoja.

Shoqeria do te kete emertimin "ALBANIAN PARTENERS ABSORBER" SHA, shkurt "APA" sh.a dhe ketu e poshte do te quhet SHOQERIA. Shoqeria ka vulen e saj te rrumbullaket ne qender se ciles do te jete logoja dhe adresa e shoqerise.


Neni 3 Selia

Shoqeria do ta kete seline ne adresen: Rruga "Hamdi Pepa" afer tregut ushqimor ne Tirane.

Neni 4 Kapitali.

Kapitali i Shoqerise eshte 2 000 000 (dymilion) leke dhe eshte i ndare me 100 (njeqind) aksione normative me vlere nominale 20 000 (njezet mije) leke secili. Ato jane te numeruar nga numri 1 (nje) deri ne numrin 100 (njeqind). Zoti Adriatik Dudaj eshte zoterues i 100 % te aksioneve te kesaj shoqerie, konkretisht zoteron aksionet nga numri 1 deri tek numri 100 duke qene keshtu aksioner i vetem i shoqerise.

Aksioneri pergjigjet per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.



Neni 5 Objekti

Shoqëria ka si objekt të saj :

Importimin, eksportimin dhe tregtimin e të gjitha llojeve të mallrave, materialeve, makinerive, automjeteve, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme, të karakterit publik, industrial, bujqësor, tregtar, ushqimor, të shërbimeve etj. në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Prodhimi i mallrave të ndryshme industriale dhe bujqësore.

Kryerjen e veprimtarive të shërbimit e riparimit të karakterit mekanik, elektrik, elektronik, komunal e të llojeve të tjera.

Veprimtari në fushën e hotelerisë, turizmit bar-restorante, fast food, lojra argetuese etj.

Studio për përgatitjen e spoteve publike, të reklamave, agjensi në fushën e reklamave, studio grafike, veprimtari në fushën e kinematografisë dhe të filmit.

Veprimtari në fushën e telekomunikacionit, si operator për ofrimin e shërbimeve të internetit, të telefonisë rurale, asaj me vlerë të shtuar, etj.

Veprimtari në fushën sportive, organizimi i garave sportive, ndërtimi dhe administrimi i qendrave sportive, përgatitja e ekipeve sportive, organizimi i trajnimit të sportistëve, trajnimeve etj.

Zhvillimin e veprimtarive në fushën e turizmit, transportit të udhëtarëve, përgatitja e guidave, shoqërive të përbashkëta turistike, etj.

Transporti i mallrave të ndryshme, eksport-importi i tyre etj.

Prodhimin (shtypshkrimin), shpërndarjen dhe tregtimin e botimeve të ndryshme si: tekste shkollore për të gjitha nivelet, libra artistike, libra tekniko-shkencore, enciklopedike, dispenca, revista, gazeta, fletore, formulare, fletë-palose, pankarta, afishe, kartvizita, portera, etj..

Për këto veprimtari Shoqëria mund të hapë njësi shitjeje të specializuara në qytete të ndryshme të vendit.

Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar e financiar që lidhet drejtpërdrejt me këtë objekt të saj.

Neni 6 Kohezgjatja

Shoqëria e fillon akvitetin e saj menjëherë me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit të Tiranës, në regjistrin tregtar. Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.



Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishjeje te pershpejtuar behet me vendim te Asamblese te Jashtezakonshme te Aksionereve.

Neni 7 Asambleja e Aksionereve.

Asambleja e Aksionereve eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e saj jane te detyrueshme per te gjithë aksioneret.

Te drejten e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Aksionereve e kane Keshilli Mbiqyres ose Drejtoria e Shoqerise. Gjithashtu ajo mund te thirret nga Eksperti Kontabel i Autorizuar ose nga aksioneret te cilet zoterojne te pakten 1/10 e Kapitalit themeltar te shoqerise.

Njoftimi per thirrjen e Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve behet te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes se aksionereve, duke parashtruar rendin e dites dhe dokumentacionin qe do te shqyrtohet.

Votat e aksionereve kane vlere proporcionale me pjesen e kapitalit te shoqerise. Cdo aksioner ka te drejten e nje vote. Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne Asamble nepermjet nje aksioneri tjeter ose nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene keta te paisur me prokure te posacme, dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Neni 8 Asambleja e Zakonshme.

Asambleja e zakonshme ka te drejten te marre vetem ato vendime te cilat jane te parashikuara ne nenin 129 dhe 130 te Ligjit me Nr.7638 date 19.11.1992 „Per shoqerite tregtare”. Asambleja e Zakonshme merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare ne rast se aksioneret e pranishem dhe te perfaqesuar zoterojne te pakten 2/3 e kapitalit themeltar te shoqerise, me te drejte vote. Ne rast se ky raport nuk arrihet mbledhja do te shtyhet per nje date te mevonshme. Ne mbledhjen e dyte nuk eshte i nevojshem raporti.

Asambleja e Zakonshme merr vendime me shumicen e votave te aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar te cilet zoterojne aksione me te drejte vote.

Asambleja e Zakoshme :

- Emeron Keshillin Mbiqyres dhe Expertin kontabel.
- Percakton shperblimin e antareve te Keshillit Mbiqyres.
- Miraton pjesemarrjen ne shoqeri te tjera.
- Miraton bilancin.
- Cdo vendim qe buron nga ligji, Akti i Themelimit dhe ky Statut.

Neni 9 Asambleja e Jashtezakonshme

Asambleja e Jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare nese jane te pranishem 2/3 e aksionereve qe zoterojne aksione me te drejte vote. Ne rast se ky quorum nuk arrihet mbledhja do te shtyhet per nje date te mevonshme jo me te larget se dy muaj nga data e



thirrjes se pare. Ne mbledhjen e dyte, Asambleja e Jashtezakonshme eshte ne gjendje te marre vendime te vlefshme nese jane te pranishem ose te perfaqesuar te pakten 1/2 e aksionereve qe zoterojne aksione me te drejte vote. Asambleja e Jashtezakonshme merr vendime me 3/4 e votave te aksioneve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje.

Asambleja e Jashtezakonshme :

- Vendos te shtoje, ndryshoje ose te zevendesojte me nje statut te ri kete statut te shoqerise.
- Vendos zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise.
- Vendos prishjen e shoqerise ose likuidimin e saj.
- Vendos ne lidhje me cdo ceshtje tjeter qe i njihet nga ligji. Akti i Themelimit dhe ky Statut.

Neni 10. Drejtoria.

1. Funksionet dhe kompetencat.

Drejtori i shoqerise perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet dhe ushtron te gjitha ato kompetenca qe i njeh ligji, me perjashtim te atyre qe ligji, Akti i Themelimit dhe Ky Statut ua njeh Asamblese se Aksionereve ose Keshillit Mbikeqyres.

Drejtori te pakten nje here ne tre muaj duhet ti paraqese Keshillit Mbikeqyres me qellim kontrolli dhe verifikimi, raportin mbi administrimin e pergatitur prej tij. Brenda tre muajeve nga mbyllja e vitit financiar te shoqerise, drejtori duhet ti paraqese Keshillit Mbikeqyres raportin vjetor dhe bilancin vjetor te shoqerise me qellim kontrolli dhe verifikimi.

1. Emerimi dhe Kohezgjatja e Mandatit.

Drejtori emerohet nga Keshilli Mbikeqyres me nje shumice votash, dhe do te qendroje ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Drejtori do te qendroje ne detyre deri ne momentin e zevendesimit te tij, ose deri ne momentin e doreheqjes, shkarkimit ose vdekjes se tij.

Drejtor i pare i shoqerise eshte emeruar zonja Ledia Çurri.

2. Vendi Vakant.

Ne rast se vendi i drejtorit mbetet vakant per shkak te doreheqjes, shkarkimit apo vdekjes se tij, ai do te zevendesohet nga nje drejtor i emeruar me vendim te Keshillit Mbikeqyres, i cili do te qendroje ne kete detyre deri ne perfundim te mandatit te drejtorit qe zevendeson.

Drejtori mund te shkarkohet per shkaqe te perligjura me vendim te Keshillit Mbikeqyres te marre me shumice te thjeshte votash te anetareve te tij.

3. Pergjegjesite.

Drejtori eshte individualisht pergjegjes ndaj shoqerise apo te treteve per demet e shkaktuara per shkak te shkeljes se dispozitave te parashikuara ne Aktin e Themelimit te shoqerise, ne kete Statut dhe ne Ligj.



Neni 11 Keshilli Mbikeqyres

1. Funksioni, Kompetencat dhe Shperblimi.

Keshilli Mbikeqyres ushtron kontroll mbi drejtorin ne lidhje me drejtimin e shoqerise.

Keshilli Mbikeqyres verifikon dhe kontrollon raportin e administratorit, raportin financiar vjetor dhe bilancin e paraqitur nga drejtori perpara se ato te aprovohen nga Asambleja e Aksionereve.

Asambleja e Aksionereve mund te caktojë një shumë fikse vjetore si shperblim per antaret e Keshillit Mbikeqyres per sherbimet e tij.

Keshilli Mbikeqyres do te kete kompetencat qe rast pa rasti te autorizojë pagimin e shpenzimeve te vecanta ne lidhje me sherbimet e tij.

2. Numri i Anetareve

Keshilli Mbikeqyres do te perbehet nga tre antare.

Keshilli Mbikeqyres do te kete kete perberje :

1. Zoti Adriatik Dudaj Kryetar.
2. Zoti..Dritan Mustafa Zv/ Kryetar
3. Zonja Arlinda Novi Dudaj Antare.

3. Emerimi, Zgjedhja dhe Kohezgjatja e Mandatit.

Cdo person i emeruar antar i Keshillit Mbikeqyres sipas ketij Statuti do te qendroje ne detyre per tre vjet rresht.

Me perfundimin e ketij mandati, Asambleja e Aksionereve do te emeroje Keshillin e ri Mbikeqyres ne perputhje me ligjin.

Anataret e Keshillit Mbikeqyres zgjedhin mes tyre Kryetarin dhe zv/Kryetarin e Keshillit Mbikeqyres.

4. Shkarkimi nga detyra

Cdo anetar i Keshillit Mbikeqyres mund te shkarkohet ne cdo moment me vendim te Asamblese se Aksionereve..

5. Vendi i Mbledhjeve.

Keshilli Mbikeqyres mund ti zhvilloje mbledhjet ne vendin e caktuar rast pas rasti nga vete Keshilli.

Neqoftese vendi i mbledhjes nuk eshte caktuar, atehere ky vend do te jete selia e shoqerise.



6. Njoftimi i Mbledhjeve.

Mbledhjet e Keshillit Mbiqeqyres do te zhvillohen pasi te jene njoftuar 14 (katërmbledhjet) dite perpara per daten dhe oren e caktuar rast pas rasti nga Keshilli Mbiqeqyres.

Mbledhjet e Keshillit Mbiqeqyres do te thirren nga kryetari i tij duke njoftuar cdo antar nepermjet telefonit, postes, postes elektronike ose me telegram ku percaktohet koha, vendi, rendi i dites qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

7. Votimi

Keshilli Mbiqeqyres eshte ne gjendje te marre vendime kur ne mbledhje jane te pranishem me shume se gjysma e antareve te tij. Vendimet merren gjithnje me shumice te thjeshte votash te antareve te pranishem ne mbledhje. Ne qofte se quorumi i siperpermendur nuk arrihet, shumica e antareve te pranishem mund te shtyjnë mbledhjen ne nje date ose ore tjeter.

Ne rast se votimi per marrjen e nje vendimi rezulton me numer te barabarte votash, atehere vota e kryetarit te Keshillit Mbiqeqyres eshte percaktuese.

8. Pergjegjesite.

Antaret e Keshillit Mbiqeqyres jane pergjegjes per gabimet personale te kryera gjate ushtrimit te mandatit te tyre.

Ne rast se antaret e Keshillit Mbiqeqyres kane dijeni per faje te bera nga antaret e drejtorise dhe nuk ja njoftojne ato Asamblese se Aksionereve, konsiderohen pergjegjes per keto faje.

Neni 12.

Ekspertet kontabel te autorizuar.

Asambleja e Aksionereve do te emeroje nje ekspert kontabel te autorizuar. Eksperti kontabel i autorizuar do te qendroje ne detyre per nje vit financiar te shoqerise.

Eksperti kontabel informon Keshillin Mbiqeqyres dhe Drejtorin e Pergjithshem per ;

Kontrollet, verifikimet dhe sondazhet qe ka kryer

Pjeset e bilancit dhe te dokumenteve te tjera te kontabilitetit ku ai ka verejtje Parregullsise dhe pasaktesite qe ai ka zbuluar.

Eskpeti kontabel merr pjese ne mbledhjet e Keshillit Mbiqeqyres, kur mbyllen llogarite e vitit financiar si dhe ne mbledhjen e Adsamblese.

Keshilli mbiqeqyres miraton masen e shperblimit per ekspertin. Marrredheniet e ekspertit kontabel me shoqerine percaktohen ne nje kontrate midis tij dhe Drejtorit te Shoqerise.

Ekspert kontabel i autorizuar i shoqerise nga Asambleja e Aksionereve eshte emeruar zoti. Bujar Osmani.

Neni 13.



Viti financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me daten 01 janar te cdo vitit dhe do te perfundoje me daten 31 Dhjetor.

Neni 14 Likujdimi

Shoqeria mund te shperndahet ne cdo kohe, kur per shkaqe te ndryshme nuk mund te vazhdoje aktivitetin e saj. Per kete ajo vihet ne likujdim. Likujdimi behet ne perputhje me kerkesat e dispozitave te ligjit "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit "Per proceduren e falimentimit"

Likuidatoret dhe kompetencat e tyre caktohen nga Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve.

Neni 15 E drejta e informimit dhe e komunikimit

Cdo aksioner ka te drejten e komunikimit e te informimit te vazhdueshem. Para cdo mbledhje apo konsulte te Asamblese, aksioneri ka te drejten e njohjes me dokumentacionin dhe problemet qe do te diskutohen apo do te konsultohen, te cilat duhen ti vihen ne dispozicion ne kohen e duhur.


Te gjitha aksioneret, antaret e Keshillit Mbikeqyres, antaret e drejtorise dhe te punesuarit jane te detyruar te ruajne fshehtesine e cdo informacioni apo te dhene ne lidhje direkte apo indirekte me shoqerine, qe e kane mesuar gjate ushtrimit te aktivitetit apo ne menyre te terthorte. Ata pergjigjen per pasojat e demshme qe i shkaktohen shoqerise nga perhapja e paautorizuar e informacionit.

Neni 16 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me Aktin e Themelimit, kete Statut dhe me dispozitat e legjislacionit Shqiptar ne fuqi. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut, do te zbatohet ligji me Nr.7638 date 19.11.1992: "Per shoqerite tregtare" dhe dispozitat e Kodit Civil.

Neni 17 Mosmarrveshjet

Mosmerreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo mosmarrveshje tjeter qe mund te linde ndermjet shoqerise dhe te treteve, kur ato nuk mrrihen te zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen ne Gjykatat Shqiptare.



Neni 18

Shtesa dhe ndryshime ne statut.

Ky Statut mund te shtohet, te ndryshohet ose te zevendesohet me nje Statut te Ri me vendim te Asamblese se Aksionereve.

Neni 19


Gjuha, kopjet dhe nenshkrimi i statutit.

Ky statut eshte hartuar ne gjuhen shqipe, ne kater kopje origjinale secila me vlere te barabarte.

Hartuesi i ketij statuti e gjeti ne pajtim te plote me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan rregullisht ate me daten 12 Maj 2004.

AKSIONERI I VETEM

Adriatik DUDAJ



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE**

Nr. 2899 Rep.

VERTETIM

Sot, në Tiranë, në datën 22/05 /2004 perpara meje, Noterit u paraqit personalisht zoti **Adriatik Dudaj**, i biri i Gafurit, lindur me 1970 ne Tirane, banues ne Tirane, Rr "Sami Frasheri" Nr. 41 Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, Aksioner i vetem dhe Drejtor i Pergjithshem i SHA "**ALBANIAN PARTNERS ABSORBER**" Sh.A , shkurt "**APA**"

Personi i mësipërm është madhor, me zotësi të plotë për të vepruar dhe i njohur personalisht prej meje. Pasi unë, Noteri, ia lexova dhe ia shpjegova, **Statutin dhe Aktin e themelimit**, bashkëngjitur këtij vërtetimi, ai më deklaroi se i kupton, i pranon dhe se i ka hartuar ato në përputhje të plotë me vullnetin e tij të lirë. Pasi i nënshkroi perpara meje rregullisht, unë e vërtetoj kete gje sipas ligjit.

NOTERI

